



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 519/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga Ferit Osmani kryesues, Vllastimir Dimic dhe Nehat Idrizi anëtarë, përkatësi me ankesat e subjektit politik Fryma e Re (FER) paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) në lidhje me parregullsi gjate procesit zgjedhor, në seancën e mbajtur më 15.12.2010, mori:

VENDIM

HIDHEN poshtë si te palejuara ankesat subjektit politik Fryma e Re (FER), përkatësisht me date 13. 12. 2010 dhe numër lende A519, A522, A523 dhe A524

ARSYETIMI

Më datë 13.12.2010 PZAP-i ka pranuar 4 (katër) ankesa me numër lende A519, A523, A522 dhe A524 nga subjekti politik FER kundrejt KQZ-se, ne te cilat parashtruesi pretendon respektivisht se:

A519- Ne shkollën “Arberia”, Gjilan, dt. 12.12.2010 ora 15:00 “sprejat kane qene te spërkatur me uje dhe ne orën 10:00 për shkak te mungesës se sprejave ne ketë shkolle është mbyllur QV 0403/02R; ne te gjithë komunën e Gjilanin ka pasur vetëm 17(shtatembedhjete) vëzhgues prej FER; ne katin 1- klasa 2 te shkollës Arberia ka ardhur edhe një person i vendvotimeve dhe ka kërkuar prej komisionereve te perdori sprejin me gishtin e tij pasi nuk ka pasur detektor”. Ne mbështetje te pretendimeve parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë prove, me përjashtim te një numri telefoni i cili i përket Sala Mehmeti;

A522- Ne shkollën fillore “Naim Frasheri”, Prishtine, QV 1913/05D, vëzhguesja Lavdije Sopi, raporton se “gishtat nuk po kontrollohen me detektor dhe askush ne vendvotim nuk ka reaguuar; “Naim Cakolli ka qene personi përgjegjës për detektor, por ai ka dal ne korridor dhe njerëzit kane votuar pa ju kontrolluar gishtat”. Ne mbështetje te pretendimeve parashtruesi i ankesës nuk ka paraqitur asnjë prove, përveç se ka siguruar vetëm një numër telefoni i cili i përket Lavdije Sopot ne rolin e vëzhgueses se FER-it;

A523- “Ne shkollën “Dardania”, Prishtine -140, salla 02, prej orës 7:00 llampat kane qene te dobëta dhe janë ndërruar ne orën 10:00”; Ne mbështetje te pretendimeve parashtruesi nuk ka bashkangjitur asnjë prove, me përjashtim te një numri telefoni i cili i përket vëzhgueses se FER, Ardijana Alijevic;

A524- “Vëzhguesi raporton se 15 persona kane votuar me llamp te keqe; me ardhjen e ENEMO-s janë ndërruar bateritë; është vërejtur një numër i madh i votuesve te cilet kane votuar me llampa te dobta”. Ne mbështetje te pretendimeve, parashtruesi i ankesës nuk ka paraqitur asnjë prove, përveç se ka siguruar një numër telefoni i cili i përket Lorik Rexhaj, ne rolin e vëzhguesit te FER.

Neni 59 paragrafi 2 i LZP-së, specifikon si me poshte:

59.2 KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve ne pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji;

Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, neni 6.3 dhe 6.4 (Vendimet për Ankesat) parasheh si vijon:

6.3 “Me qellim te lehtësimit te shyrtimeve te ankesave, kryesuesi i panelit mund te vendose ta bej bashkimin e ankesave qe perbajne ne vete çeshtje te ngjashme, paneli vendimmarrës i trajton ato si kur te ishin një ankese”.

6.4 “Panelet mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo at të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie”.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

-ankesat janë te palejuara

PZAP-i vlerëson se ankesat e FER paraqitur përkundrejt KQZ-se janë jashtë juridiksionit te PZAP, për shkak se KQZ është organi i cili merret me funksionalizimin dhe organizimin e zgjedhjeve duke përfshire edhe përdorimin e detektorëve gjate procesit te zgjedhjeve, fakt ky qe konfirmohet nëpërmjet Rregullës Zgjedhore Nr. 09/2009. Prandaj për këtë arsye dhe ne pajtim te dispozitave ligjore te cekura me larte si dhe ne pajtim te nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshire është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 519/2010 më datën 15.12.2010.

